



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 106

Tiranë – E enjte, 11 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 5, datë 10.5.2017	Për delegimin e kompetencave..... 5803
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 3.5.2017	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik te Ministria e Arsimit dhe Sportit, për Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), të pronës së paluajtshme shtetërore, apartamentet nr.15, nr.16, nr.17 dhe nr.18, të ndodhura në godinën nr.57, në bulevardin “Zogu i Parë”, Tiranë..... 5803
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 3.5.2017	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) 5805
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 398, datë 3.5.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar..... 5806
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 3.5.2017	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve financiare që u kryen në kuadër të organizimit të aktiviteteve për kryerjen e ceremonialit funebër, në nderim të të ndjerit Dritëro Agolli..... 5808
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 3.5.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 19.7.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve”, të ndryshuar..... 5808
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 3.5.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 1108, datë 30.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujtjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit” 5809

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 3.5.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i shesheve të fshatrave Allambrez, Cukalat, Kutalli dhe Poshnje”, Ura Vajgurore.....	5809
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 404, datë 3.5.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për ndërtim kopshtesh dhe ambulancash në territorin e bashkisë Ura Vajgurore”	5810
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 3.5.2017	Për lirim nga detyra të prefektit të Qarkut të Tiranës.....	5811
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 3.5.2017	Për lirim nga detyra të prefektit të Qarkut të Durrësit.....	5811
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 3.5.2017	Për lirim nga detyra të prefektit të Qarkut të Elbasanit.....	5811
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 3.5.2017	Për lirim nga detyra të prefektit të Qarkut të Beratit.....	5812
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 409, datë 3.5.2017	Për lirim nga detyra të prefektit të Qarkut të Korçës.....	5812
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 3.5.2017	Për lirim nga detyra të prefektit të Qarkut të Dibrës.....	5812

**VENDIM****Nr. 5, datë 10.5.2017****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë”, nenit 9 dhe 22 të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit nr. 22, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, seksioni “delegimi i detyrave”

VENDOSA:

1. Në mungesë, apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave, si nëpunëse e autorizuar, delegoj Znj. Etleva Zeqo, Drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Administrativ, për kryerjen e pagesave për të gjithë zërat e shpenzimeve.

2. Kryerja e pagesave për shpenzimet në artikujt 600 dhe 601 i delegohen Znj. Etleva Zeqo, Drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Administrativ, pavarësisht nëse nëpunësi autorizues është apo jo në mungesë, apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave.

3. Kompetencat e deleguara, do të ushtrohen nga data 10.5.2017 deri në datën 31.12.2017.

4. Raportimi të kryhet tek nëpunësi Autorizues, me shkrim çdo muaj pasardhës, për realizimin e detyrave të ngarkuara.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Albana Shtylla

VENDIM**Nr. 396, datë 3.5.2017**

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA DREJTORIA E
SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK
TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SPORTIT, PËR AGJENCINË
KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR
DHE INOVACIONIT (AKKSHI), TË
PRONËS SË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, APARTAMENTET NR.15,
NR.16, NR.17 DHE NR.18, TË NDODHURA
NË GODINËN NR.57, NË BULEVARDIN
“ZOGU I PARË”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:



1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik te Ministria e Arsimit dhe Sportit, për Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), të pronës së paluajtshme shtetërore, apartamentet nr. 15, nr. 16, nr. 17 dhe nr. 18, të ndodhura në godinën nr. 57, në bulevardin “Zogu i Parë”, Tiranë, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



**VENDIM****Nr. 397, datë 3.5.2017****PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË FINANCIMIT TË
ARSIMIT TË LARTË (AKFAL)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) të organizohet dhe të funksionojë si person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me seli në Tiranë.

2. AKFAL-i ka për mision shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, mbështetjen me bursa studimi për studentët dhe garantimin e skemës së kredive studentore, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

3. AKFAL-i ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Propozon në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kriteret dhe formulën për shpërndarjen e fondeve publike, të cilat miratohen nga kjo ministri;

b) Në bazë të kriteve e të formulës së miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, AKFAL-i:

i) shpërndan fondin për mbështetjen e institucioneve të arsimit të lartë dhe infrastrukturën akademike;

ii) shpërndan fondin për projektet konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë;

iii) shpërndan fondin e mbështetjes studentore.

c) Garanton skemën e kredive studentore, sipas akteve nënligjore në fuqi;

ç) Miraton paraprakisht hapjen e programeve të reja të studimit në një institucion publik të arsimit të lartë, kur kërkohet që këto programe të financohen nga buxheti i shtetit;

d) Boton raporte periodike për aspekte të funksionimit administrativ dhe financiar të IAL-së, si numri i studentëve, numri i pedagogëve, infrastruktura e kërkimit, numri i studentëve të diplomuar që punësohen, numri i patentave etj;

dh) Paraqet në institucionet e arsimit të lartë “dokumentin e prioriteteve”, ku përcaktohet struktura e shpenzimit të fondit publik për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në përputhje me prioritetet e vendit, 6 muaj përpara financimit;

e) Nënshkruan me çdo institucion të arsimit të lartë që financon kontratën e garancisë e të llogaridhënies, e cila përmban kushtet specifike të institucionit, financimin përkatës, edukimin akademik që institucioni do të ofrojë nëpërmjet këtij fondi, strukturat e brendshme financiare të institucionit të arsimit të lartë, skemën e kontrollit të brendshëm financiar dhe mënyrën e kontrollit të jashtëm financiar;

ë) Boton çdo vit udhëzuesin, i cili përmban informacionet e nevojshme që duhet të përfshijnë institucionet e arsimit të lartë në raportin e tyre vjetor financiar;

f) Publikon udhëzime lidhur me mënyrat dhe format e menaxhimit të qëndrueshëm financiar të institucioneve të arsimit të lartë;

g) Kryen për çdo institucion të arsimit të lartë të financuar vlerësimin e riskut dhe qëndrueshmërisë financiare, sipas procedurave të auditimit publik;

gj) Kryen vlerësimin e kushteve që duhet të plotësojnë institucionet e arsimit të lartë për aplikim për kredimarrje;

h) Vlerëson respektimin e kushteve të skemës së kredisë studentore nga institucionet kredidhënëse;

i) Publikon raportin e financimit të institucioneve të arsimit të lartë për çdo vit akademik;

j) Administron të dhënat statistikore për institucionet e arsimit të lartë.

4. AKFAL-i financohet nga buxheti i shtetit dhe nga çdo burim tjetër financiar i ligjshëm.

5. Organet e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) janë Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKFAL-it, të cilët drejtojnë dhe administrojnë agjencinë.

Bordi Drejtues është organi kolegjial vendimmarrës i AKFAL-it, që përbëhet nga:

- Nëpunësi i parë autorizues i Ministrisë Financave;

- Nëpunësi autorizues i ministrisë përgjegjëse për arsimin;

- Dy rektorë nga IAL-ja, propozuar nga Konferenca e Rektorëve;

- Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave.



Bordi i Drejtues asistohet nga sekretariati, që përbëhet nga nëpunës të AKFAL-it, të përcaktuar nga drejtori i Përgjithshëm.

6. Funksionet e Bordit Drejtues janë:

a) Propozon kriteret për shpërndarjen e fondeve publike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

b) Propozon “dokumentin e prioriteteve” në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

c) Miraton shpërndarjen e fondit për institucionet, pjesë e grantit të mësimdhënies;

ç) Miraton shpërndarjen e fondit të mbështetjes studentore, pjesë e grantit të mësimdhënies;

d) Miraton format e garantimit të skemës së kredive studentore;

dh) Miraton hapjen e programeve të reja të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, kur kërkohet financim nga buxheti i shtetit;

e) Miraton raportet periodike për aspekte të funksionimit administrativ dhe financiar të IAL-ve;

ë) Miraton udhëzuesin lidhur me informacionet e nevojshme që duhet të përfshijë IAL-ja në raportin e tyre vjetor financiar;

f) Miraton udhëzimet për mënyrat dhe format e menaxhimit të qëndrueshëm financiar të IAL-ve;

g) Miraton vlerësimet e riskut dhe qëndrueshmërisë financiare të IAL-ve;

gj) Kryen vlerësimin e kushteve që duhet të plotësojnë IAL-të për aplikim për kredimarrje;

h) Vlerëson respektimin e kushteve të skemës së kreditë studentore nga institucionet kredidhënëse;

i) Miraton raportin e financimit të IAL-ve, për çdo vit akademik;

j) Miraton rregulloren e brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL-it.

7. Anëtarët e Bordit Drejtues të AKFAL-it shpërblehen në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për mbledhje, për jo më shumë se 12 mbledhje. Drejtori i Përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues pa të drejtë vote.

8. AKFAL-i drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit të Arsimit dhe Sportit.

9. Drejtori i Përgjithshëm i AKFAL-it është titullari i institucionit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretë.

10. Drejtori i Përgjithshëm i AKFAL-it emërohet, lirohet nga detyra, sipas përcaktimeve të legjislacionit të shërbimit civil.

11. Funksionimi i brendshëm i AKFAL-it bëhet

sipas rregullores përkatëse të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

12. Struktura dhe organika e AKFAL-it miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit.

13. AKFAL-i ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen nga ministri i Arsimit dhe Sportit, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të AKFAL-it.

14. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë”, në përputhje me vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.

15. Vula zyrtare e AKFAL-it ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 11, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e AKFAL-it prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 398, datë 3.5.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 682, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21, pika 4, 22, pika 2, 23, pika 2, 24, pika 4, dhe 25, pika 4, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, neneve 5, 6, 19 dhe 28, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, kreut II, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportin rrugor”,



të ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozim të ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“a) Punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator), të institucioneve arsimore publike, që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në largësinë mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim.”

b) Pika 2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësitë arsimore (drejtoritë rajonale arsimore/zyrat arsimore) miratojnë hartën e linjave, mbështetur në numrin e punonjësve mësimorë, nxënësve dhe fëmijëve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, sipas kriterëve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi. Njësitë arsimore (drejtoritë rajonale arsimore/zyrat arsimore), pas hartimit të listave të përfituesve, i konfirmojnë ato edhe te njësitë e vetëqeverisjes vendore për distancën nga vendbanimi i përhershëm.”

c) Pika 3 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“3. Njësitë arsimore (drejtoritë rajonale arsimore/zyrat arsimore), mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të fëmijëve, nxënësve dhe punonjësve arsimorë sipas hartës së linjave të shërbimit të transportit publik, të licencuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose qendrore.”

ç) Pika 4 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“4. Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi, njësitë arsimore vendore realizojnë

mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë.

Masa e shpenzimeve mujore që përfiton çdo nxënës dhe punonjës mësimor përllëgaritet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të nxënësve dhe mësuesve që kanë ndjekur mësimin, çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetase apo rrethqytetase të shërbimit të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtareve”, të ndryshuar, indeksimit të çmimeve të shërbimit të transportit, të botuara çdo vit nga INSTAT-i, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.”

d) Pika 5 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“5. Punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar, që përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit të siguruar nga njësitë arsimore vendore, të parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë shpërblim mujor të diferencuar, sipas pikës 4, të vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, sipas distancave, si më poshtë vijon:

a) në masën 1 000 (njëmijë) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm i tyre/qendra e punës deri në institucionin arsimor publik është në distancën mbi 5 km deri në 10 km;

b) në masën 1 500 (njëmijë e pesëqind) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm/qendra e punës deri në institucionin arsimor publik është në distancën mbi 10 km deri në 20 km;

c) në masën 2 700 (dymijë e shtatëqind) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm/qendra e punës deri në institucionin arsimor publik është në distancën mbi 20 km.”

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, pa efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

3. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë nënshkruar kontrata për shërbimin e transportit të nxënësve dhe mësuesve për vitin buxhetor 2017 para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ky vendim do të zbatohet duke filluar nga data 1.1.2018. Për të gjithë rastet e tjera, vendimi do të zbatohet duke filluar nga data 1.7.2017.



4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, njësitë arsimore vendore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 400, datë 3.5.2017

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR
MBULIMIN E SHPENZIMEVE
FINANCIARE QË U KRYEN NË KUADËR
TË ORGANIZIMIT TË AKTIVITETEVE
PËR KRYERJEN E CEREMONIALIT
FUNEBËR, NË NDERIM TË TË
NDJERIT DRITËRO AGOLLI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Kulturës, të shtohet fondi prej 3 300 000 (tre milionë e treqind mijë) lekësh, me qëllim mbulimin e shpenzimeve financiare të realizimit të ceremonialit funebër, në nderim të të ndjerit Dritëro Agolli.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 401, datë 3.5.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 515, DATË 19.7.2006, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
RISTRUKTURIMIN E INSTITUTEVE
KËRKIMORE-SHKENCORE, NË VARËSI
TË MINISTRISË SË BUJQËSISË,
USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 13 e 14, të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994, “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalja e dytë e pikës 5, të vendimit nr. 515, datë 20.6.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshon, si më poshtë vijon:

“Detyrat kryesore të tij janë:

a) Kërkimi në nivel ferme, për problemet e ngritura nga kultivuesit e duhanit, dhe demonstrimi i teknologjive të reja të kultivimit;

b) Trajnimi i fermerëve, specialistëve të bujqësisë, që përfshihen në strukturat e bashkive, në drejtoritë e bujqësisë, dhe i subjekteve të tjera të interesuara në zonat kultivuese të duhanit;

c) Sigurimi i ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët.”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



VENDIM

Nr. 402, datë 3.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1108, DATË 30.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TE BASHKITË, TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË PERSONELIT DHE TË ASETETEVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË BORDEVE RAJONALE TË KULLIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 3, shkronja “dh”, e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tabelën 2, “Tabela e Aseteve të Qëndrueshme”, bashkëlidhur vendimit nr. 1108, datë 30.12.2015, të Këshillit të Ministrave, të hiqet nënndarja, si vijon:

Bordi i Kullimit Tiranë	Bashkia Tiranë	1 – Zyra	6587	212
		2 – Ambjente të tjera		1095

2. Asetet e qëndrueshme të Bordit të Kullimit, Tiranë, që përmenden në pikën 1, të këtij vendimi, mbeten në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministri i Shtetit për Çështjet Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 403, datë 3.5.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI URBAN I SHESHEVE TË FSHATRAVE ALLAMBREZ, CUKALAT, KUTALLI DHE POSHNJE”, URA VAJGURORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i shesheve të fshatrave Allambrez, Cukalat, Kutalli dhe Poshnje”, Ura Vajgurore.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajgurore.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “truall” dhe “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 751 100 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 751 100 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe të përfundojë me mbylljen e punimeve.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Ura Vajgurore.



8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgurore, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së

gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Ura Vajgurore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lista e shpronësimeve për projektin “Rehabilitimi urban i shesheve të fshatrave”

Nr.	Pronar	Përshkrimi	ZK	Nr.pasurisë	Sip.totale m ²	Lloji i pasurisë		Çmimi njësi	Vlera e shpronësimit	Konfirmuar ZVRPP-ja
						Truall	Are			
1	Yzedin Shahini	sheshe-lulishte	1016	994/2	1300		1000	203	203000	po
2	Lavdosh Zanaj dhe	sheshe-lulishte	1427	169/3	2650		1000	203	203000	po
3	Dritan Zanaj									po
4	Lorenc Krimce	sheshe-lulishte	2349	51/17	1200	300		203	60900	po
5	Lorenc Krimce	sheshe-lulishte	2349	51/17	1200		350	203	71050	po
6	Ilijan Gllava	sheshe-lulishte	3032	454/43	237.5	237.5		203	48212.5	po
7	Shefqet Gllava	sheshe-lulishte	3032	454/44	237.5	237.5		203	48212.5	po
8	Islam Gllava	sheshe-lulishte	3032	454/45	575	575		203	116725	po
								Totali	751100	

VENDIM
Nr. 404, datë 3.5.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PËR NDËRTIM KOPSHTESH DHE AMBULANCASH NË TERRITORIN E BASHKISË URA VAJGURORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për ndërtim kopshtesh dhe ambulancash në territorin e Bashkisë Ura Vajgurore”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajgurore.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “truall”, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 156 100 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 156 100 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe të përfundojë me mbylljen e punimeve.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Ura Vajgurore.



8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajguore, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së

gjurmës së projektit në hartën kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Ura Vajguore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lista e shpronësimeve për projektin "Ndërtim kopshtesh dhe ambulancash në territorin e Bashkisë Ura Vajguore"

Nr.	Pronar	Përshkrimi	ZK	Nr. Pasurisë	Sip. Totale m ²	Lloji i pasurisë		Çmimi Njësi	Vlera e shpronësimit	Konfirmuar ZVRPP-ja
						truall	are			
1	Agron Nazif Lika	Kopësht-ambulancë	2881	475/2	250	250		213	53250	po
2	Rrapush Qerim Mile	Ambulancë	1004	1760/9	650	50		203	10150	po
3	Xhelal Riza Xhelo	Kopësht	1093	1061/17	1400	450		206	92700	po
								Totali	156100	

VENDIM
Nr. 405, datë 3.5.2017

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Sadi Vorpsi, prefekt i Qarkut të Tiranës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 406, datë 3.5.2017

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Rolant Xhelilaj, prefekt i Qarkut të Durrësit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 407, datë 3.5.2017

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Arben Kamami, prefekt i Qarkut të Elbasanit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 408, datë 3.5.2017****PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Fadil Nasufi, prefekt i Qarkut të Beratit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 409, datë 3.5.2017****PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ardit Konomi, prefekt i Qarkut të Korçës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 410, datë 3.5.2017****PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Halit Palamani, prefekt i Qarkut të Dibrës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 112 lekë